



AKTI I THEMELIMIT

I

“UNIONIT FINANCIAR RURAL”

Ne baze te ligjit nr. 8782, datë 03.05.2001 “ Për Shoqëritë Kursim- Kredi”, formohet Unioni i quajtur “Unioni Financiar Rural”, nga Shoqërite themeluese te cilat nenshkruajne ne fund te ketij Akti, me poshte i quajtur “Unioni”.

Neni 1 - Emërtimi

Emërtimi i Unionit është “Unioni Financiar Rural”

Neni 2 - Selia

Selia e Unionit është caktuar në adresën: Ismail Qemali, P.32, Tirane, Shqiperi.

Neni 3 - Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarise se Unionit është per nje periudhe te pacaktuar kohore, duke filluar nga koha e regjistrimit të saj pranë zyrës së Regjistrimit të Gjykatës së Rrethit Tirane.

Neni 4 - Objekti

Objekti i Unionit është:

- të marrë depozita me ose pa interes vetëm nga anëtarët e Unionit Financiar Rural.
- te siguroje mundesine e kthimit korrekt te kredive.
- t'u japë hua vetëm anëtarëve të Unionit Financiar Rural dhe të përcaktojë afatet dhe kushtet që shoqërojnë.
- të inkurajojë ndihmën reciproke dhe edukatën ekonomike të anëtarëve të tij.
- te perfaqësojë dhe ndihmojë shoqërite anëtare, duke siguruar programe dhe shërbime, të cilat lejojnë shoqëritë e kursim-kreditit, t'u shërbejnë me më frytshmëri anëtarëve të tyre.
- te shtrije veprimtarine e ketyre shërbimeve, por pa qenë të kufizuar ndaj tyre, ne fusha si: arsimi dhe kualifikimi, këshillimi drejtues dhe kontabiliteti, sistemet e standardizuara, furnizimet dhe format, marketingu dhe prokurimi, drejtimi i riskut dhe sigurimi, përkrahja para qeverisë e publikut në përgjithësi.
- te përfaqësoje të gjithë rrjetin të Shkk - ve, dhe anëtarë të tij, para qeverisë, autoritetit mbikëqyrës etj.

Neni 5 - Kontributet e anetaresimit

Çdo shoqëri anetare derdh në momentin e pranimit për anëtarësim 1 (nje) pjesë anëtarësimi me vlerë 1.000 (njemije) lekë, që i përgjigjet vlerës së 1 (nje) kontributi anetaresimi.

Neni 6 - Kapitali Themeltar

Kapitali fillestar i Unionit përbëhet nga vlera e pergjitheshme e kontributeve te anetaresimit të vendosura nga anëtarët themelues. Kapitali fillestar i Unionit është 10.000 lekë. (dhjetemije).

Neni 7 - Organet Drejtuese te Unionit

Organet drejtuese te Unionit "Financiar Rural jane:

1. Asambleja e e Pergjitheshme;
2. Bordi drejtues;
3. Komiteti Mbikqyres.

Neni 8 - Asambleja e pergjitheshme

Asambleja e pergjitheshme eshte organi vendimor i Unionit. Ajo perbehet nga te gjithe Shoqerite e Unionit, dhe vendimet e saj jane te detyrueshme per çdo anetar te saj.

Neni 9 - Bordi drejtues

Administrimi i Unionit e drejtimi i tij bëhet nga Bordi drejtues i zgjedhur prej Asamblese se pergjitheshme, i përbërë nga jo me pak se tre vete.

Anetare te Bordit Drejtues jane:

Kryetar - Z. Zana Konini, Nen/Kryetar - Z. Rahim Teqja, anetar - Z. Kristaq Dhima, Josif Prifti, Lufi Lala, Ahmet Demaj, Servet Balla.


Anëtarët e Unionit, i japin Kryetarit të Bordi drejtues të mësipërm të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe kërkesat e parashikuara për themelimin e Unionit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ai është i autorizuar të veprojë në emër të Unionit që po themelohet deri ne regjistrimin e saj në regjistër. Ai pajiset me mandat për të firmosur të gjitha aktet dhe të kontraktot në emër të Unionit për të gjitha detyrimet që lindin nga momenti i regjistrimit të saj pranë Gjykatës së rrethit Tiranë.

Në statut caktohen kufijtë dhe ndarja e kompetencave të bordit drejtues dhe Kryetarit.

Neni 10 - Komiteti mbikqyrës

Komiteti mbikqyrës ka për mision të mbikqyrë veprimtarinë administrative dhe administrimin financiar të Unionit sipas ligjit dhe statutit, ai përbëhet nga te pakten 3 (tre) anetare. Komiteti i pare mbikqyrës perbehet nga Kryetare - Znj. Bakushe Kulli, Nen/Kryetar - Z. Nuri Kurti, anetar - Z. Fatosh Danaj.





Neni - 11 Sekret

Anëtarët janë të detyruar të mbajnë sekret dokumentacionin teknik, informacionet etj. Të specifikuarat këto në rregulloret që do të nxirret më vonë.

Neni 12 - Shpërberja -Likuidimi

Shpërberja e Unionit mund të ndodhë, kur kapitali zvogelohet nën tre të katërtat e shumës maksimale, kur Unioni ploteson afatin e veprimtarisë, me dëshirën e të gjithë anëtarëve ose për arsye të parashikuara në rregulloret e saj.

Asambleja e përgjithshme e jashtëzakonshme ose asambleja e zakonshme vjetore, ka autoritetin për të bërë ose për të shpallur shpërberjen e Unionit.

Mbështetur në vendimin e asamblesë së përgjithshme, për shpërberjen e Unionit, gjykata përcakton likuidatorin për të kryer procedurat e likuidimit të Unionit.

